

VENDIM
Nr.550, datë 3.8.2005

**PËR ZGJATJEN E VEPRIMTARISË SË FONDACIONIT “QENDRA PËR EFIÇENCËN E
ENERGJISË SHQIPËRI-BASHKIMI EUROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të aktit të krijimit të fondacionit “Qendra për efiçencën e energjisë Shqipëri-Bashkimi European”, miratuar me vendim nr.349, datë 5.6.1995 të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Zgjatjen e veprimtarisë, me të njëjtin objektiv për të cilin është themeluar, të fondacionit “Qendra për efiçencën e energjisë Shqipëri-Bashkimi European”, edhe për një periudhë tjetër 5 - vjeçare.

2.Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës të parashikojë, në buxhetin e çdo viti, fondet përkatëse, të nevojshme për këtë qendër.

3.Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano